



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punë/Prezantuar Received/Delivered	19.11.2021	viti god year	2021
Organ Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	SKGJK	Nr Prot Pr Prot Prot No	5550/2021
		Shtojca Prilog Appendix	
		Sasia Kolicina Quantity	1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.829/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti anëtarë si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri, Bashkëpunëtorë Profesionale, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.829/2021 të datës 23.09.2021, të parashtruar nga ankuesi me banim në fshatin Kline e Epërme në Komunën e Skenderajt, në çështjen juridike "kompensim material" kundër organit të punësimit-Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK), duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.11.2021 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.829/2021 e datës 23.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.42/2021 i datës 27.08.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi - Referent në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - dega Skenderaj, me datë 23.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4754/2021 të regjistruar me numër A.nr.829/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.42/2021 të datës 27.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli, me datë 21.10.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.11.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr.43/2021 me të cilin ka bërë vazhdimin e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për 10 ditë pune, sipas kërkesës së kryetarit të Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4754/2021 të regjistruar me numër A.nr.829/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës i datës 05.10.2021 me numër të protokollit 4902/2021; Vendimin e datës 11.06.2021 me numër Ref: DS-276/2021 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit; Vendimin e datës 21.07.2015 me numër të protokollit 03/193 mbi përvojën e punës për realizimin e shtesës prej 0.5%; Deklaratën nën Betim të datës 18.06.2015; Vërtetimin e datës 14.07.2021 me numër 144/2021; Vendimin e datës 12.07.2021 me numër 03/125 të Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit Gjyqësor të Kosovës; Vërtetimi mbi pranimin e dërgesës së postes; Vendimin e datës 27.08.2021 me numër 09/1429 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Pasqyra e llogaris bankare për virin 2012 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.10.2021 me numër të protokollit 4918/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2021 me numër të protokollit 5110/2021; Ankesën e datës 29.07.2021 me numër të protokollit 01/1323 drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit Gjyqësor të Kosovës; Dëshminë për pagesën e një page përcjellëse për ankuesin për periudhën 01.07.2021-31.07.2021; Emalin e datës 26.10.2021 me numër të protokollit 5175/2021; Dëshminë lidhur me pagesën e pagës jubilarë për vitin 2013; Kërkesën e datës 08.09.2021 me numër të protokollit 5354/2021 për shtyrjen e afatit për vendosje në ankesë; Vendimin e datës 09.11.2021 me numër të protokollit 5355/2021 për vazhdimin e afatit për vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Përmes Vendimit me numër reference DS:276/2021 të 27.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 12.06.2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Të njëjtit me këtë vendim i është njohur e drejta e një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, dhe kompensimi i një page në vlerë prej 150 euro për muajin prill, maj dhe qershor 2021, sipas Vendimit të Qeverisë Nr.18/60 të datës 07.08.2018. Kolegji bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht listat e pagave të muajit dhjetor 2013 ka konstatuar se ankuesi në emër të pagës jubilarë ka realizuar 82.50 euro, ndërsa pas arritjes së moshës së pensionimit, me listën e pagave të muajit korrik 2021 i njëjti ka realizuar 585.58 euro.

Ankuesi ka parashtruar kërkesë në SKGJK, për kompensimin e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, si dhe kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar. Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së me datë 12.07.2021 ka nxjerr Vendimin me numër reference DS-350/2021 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se të njëjtit i janë njohur të drejtat sipas dispozitave ligjore në fuqi, përkatësisht nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenit 19 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë.

Ankuesi kundër Vendimit DS-350/2021 të datës 12.07.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, me datë 29.07.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së. Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 27.08.2021 ka nxjerr Vendim KA.nr.42/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit KA.nr.42/2021 të datës 27.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, me datë 23.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të Shkeljes së Ligjit të Punës dhe Ligjit për Shërbimin Civilë; dhe Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I njëjti pretendon në njohjen e drejtës për kompensimin e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive në Kosovë, si dhe kompensimin e pushimit vjetor të pushfrytëzuar sipas Rregullores për Pushimet e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore lidhur me njohjen e te drejtës për kompensimin e dy (2) pagave përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë ka analizuar Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 me datë 18.06.2014, mbi bazën e të cilës janë ngritur pretendimet ankimore, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj, duke marr parasysh se ankuesit sipas fuqisë ligjore i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 12.06.2021, pretendimet ankimore të ankuesit mbi këtë bazë ligjore janë të pa bazuara.

Pas konstatimit se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk ka qenë në fuqi në kohën e përfundimit të marrëdhënies së punës së ankuesit, Kolegji konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit DS:276/2021 të 27.05.2021 dhe Vendimit DS-350/2021 të datës 12.07.2021, me të cilin ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit, respektivisht i është refuzuar kërkesa për kompensimin edhe të dy (2) pagave përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë, ka vepruar në pajtim dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e pushimit vjetor të pushfrytëzuar, dhe rrjedhimisht duke iu referuar legjislacionit të aplikueshme në rastin konkret, gjegjësisht nenin 39 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5 paragrafit 8 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, konstatoj se pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar, përjashtimisht në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil. Andaj, duke marr parasysh se me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, arritja e moshës së pensionimit nuk konsiderohet ndërprerje por përfundim i marrëdhënies së punës, për të cilën nëpunësi civil duhet të jetë i njoftuar gjashtë (6) muaj me herët, Kolegji vlerëson se kompensimi i pushimit vjetor në rastet e tilla nuk ka mbështetje ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë e cila dëshmon se ankuesit nuk i është lejuar shfrytëzimi i pushimit vjetor, andaj vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë SKGJK-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.42/2021 të datës 27.08.2021 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031

për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.829/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

[Signature]
Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.